



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË**

**MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
KRESHNIK HAJDARI**

RREGULLORE

**PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR
MBROJTJEN NGA HAKMARRJA NË BASHKINE KUCOVE**

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkine Kucove, bazohet në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga I.L.D.K.P.K.I

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.
2. “Hakmarrje” është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim, i kryer nga organizata, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.
3. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligjit nr. 60/2016, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
4. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
5. “Mbrojtje” është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të ligjit nr.60/2016.
6. “Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda bashkise Kucove, i përbërë nga 2(dy) punonjës të bashkise dhe e ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.
7. “Organizatë” është Bashkia Kucove dhe njesite apo ndermarjet e varesise.
8. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek Njësia Përgjegjëse ‘per Sinjalizimin dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve’ qe eshte ngritur e funksionon ne bashkine Kucove, ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në bashkine Kucove.
9. “Sinjalizues” është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë bashkise Kucove, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
10. “Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

KREU II
VEPRIMET PROCEDURALE

Neni 4

Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të “Njesise Pergjegjese” kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Njesia Pergjegjese cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 5

Mbrojtja kundër hakmarrjes

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas ligjit nr. 60/2016, mbrohet ndaj çdo masë hakmarrëse të marrë ndaj tij nga Bashkia Kucove, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - a. shkarkimin nga puna;
 - b. pezullimin nga puna, ose të një, ose më shumë detyrave;
 - c. transferimin brenda ose jashtë bashkise Kucove;
 - d. uljen në detyrë;
 - e. uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
 - f. humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
 - g. mosngritjen në detyrë;
 - h. heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
 - i. vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
 - j. forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.
2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.
3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të bashkise, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, paraqet kërkesë me shkrim tek Kryetari I Bashkise dhe një kopje e saj i dërgohet “Njesise Pergjegjese”.

4. Bashkia merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë. Në rast të mos miratimit apo moskthimit të përgjigjes brenda 5 ditësh nga data e paraqitjes së saj, Njësia Përgjegjëse, me kërkesë të sinjalizuesit, menjëherë i drejtohet organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për të urdhëruar autoritetin public, të marrë të gjitha masat, sipas këtij neni.
5. Nëse organi kompetent i Bashkisë Kucove nuk merr masat e kërkuara, Njësia Përgjegjëse i drejtohet me kërkesë padi gjykatës kompetente.

KREU III

HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 6

Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje

1. Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, fillimisht duhet të paraqesë kërkesë për mbrojtje tek “Njësia Përgjegjëse” e bashkisë Kucove.
2. Njësia përgjegjëse merr menjëherë masat dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkeljes së këtij afati, kërkesa e sinjalizuesit paraqitet tek ILDKPKI-ja, që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës për riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes.

Neni 7

Hetimi administrativ dhe barra e provës

1. Njësia Përgjegjëse heton administrativisht pretendimet për hakmarrje për të përcaktuar nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur, është duke ndodhur, ose pritet të ndodhë një akt hakmarrjeje.

Neni 8

Bashkëpunimi

1. Bashkia dhe sinjalizuesi bashkëpunon me Njesine Pergjegjese, në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes së aktit të hakmarrjes ndaj sinjalizuesit. Bashkia është e detyruar të paraqesë informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara Njesise Pergjegjese.
2. Bashkia Kuçove çdo deklaram apo argument të saj e paraqet me shkrim.

Neni 9

Mjetet e kërkimit të provës

1. Gjatë hetimit administrativ Njesia pergjegjese me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen mund:
 - a. të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë;
 - b. të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
 - c. të vizitojë vende të caktuara.
2. Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes së aktit të hakmarrjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, Njesia Pergjegjese kryesisht apo me kërkesën e sinjalizuesit, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).
3. Njesia Pergjegjese që zhvillon procedurën administrative mund të vendosë sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi Njesine Pergjegjese.

Neni10

Njoftimi i sinjalizuesit

1. Njesia Pergjegjese njofton me shkrim sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për statusin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë.
2. Pavarësisht nga afatet e njoftimit, Njesia Pergjegjese është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion me shkrim, paraqitur në çdo kohë nga sinjalizuesi në lidhje me kërkesën e tij.

KREU IV

AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT

Neni 11

Masat në përfundim të hetimit administrativ

1. Nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga Bashkia Kucove, Njesia Pergjegjese i drejtohet me shkrim organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për të urdhëruar bashkine për marrjen e të gjitha masave për riparimin e shkeljes së kryer.
2. Sinjalizuesi ka te drejte te kerkoje ne gjykate shperblim per demin e pesuar nga akti I hakmarrjes, ne kuptim te ligjit nr. 60/2016, sipas Kodit Civil ne Republiken e Shqiperise.

Neni 12

Afati i përfundimit të hetimit administrativ

Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

NJESIA PERGJEGJESE

Kucove Mars 2022

